POSTIM ARKIVOR

Jusuf (Isuf) Vrioni, (1916-2001)



SEKSIONI

Intelektualë, shkencëtarë

PERIUDHA

1947 - 1991

Jusuf Vrioni (16 mars 1916 – 1 qershor 2001) lindi në Korfuz . Ishte djali i Iliaz Vrionit , ish-kryeministër dhe diplomat shqiptar. Studioi në Francë dhe Itali, ku mori titullin “Doktor në Drejtësi”. U kthye në Shqipëri më 1939, por në vitin 1947 u arrestua nga regjimi komunist si “agjent francez” dhe u dënua me 15 vjet burg. Pas lirimit punoi si përkthyes, duke sjellë në frëngjisht veprat e Ismail Kadare dhe disa libra të Enver Hoxha . Pas rënies së komunizmit u emërua ambasador pranë UNESCO në Paris. Në vitin 2006 Ministria e Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve e Republikës së Shqipërisë krijoi çmimin e përkthimit “Jusuf Vrioni”. Në vitin 1998 u dekorua nga Franca me titullin “Chevalier de la Légion d’Honneur”. Vdiq në Paris më 2001.

KULTURA SHQIPTARE NË BOTË

UNESCO


Dokumentacioni për Jusuf (Isuf) Vrionin në dosjet e Sigurimit të Shtetit

Dokumentacioni për Jusuf (Isuf) Vrionin në dosjet e Sigurimit të Shtetit gjendet në dy dosje: dosjen heti-more-gjyqësore nr. 1355-A dhe dosjen e përpunimit nr. 1452. Dosja hetimore-gjyqësore nr. 1355-A është një përmbledhje hetimore dhe procesi gjyqësor i 17 të akuzuarve si agjentë francezë: Agostin Bonati, Skënder Konica, Skënder Shkupi, lindur në Shkup, Guliem Rasku, Rakip Strazimiri, Isuf Vrioni (Jusuf Vrioni), Agop Hamexhani, Simon Rasku, Fridë Sadedini, Adem Pilku, Padër Paskal Gjuderi, Lush Pogu, Gjysh Shkreli, Elena Beçi, Lucia Kola, Gjon Cefa, Kosta Meksi. Të 17 personat akuzohen si agjentë francezë, që kanë dhënë informata Misionit Francez e më pas Legatës Franceze të vendosur në Tiranë. Tri nga të akuzuarit ishin shtetas të huaj (bullgar, armen dhe francez), gjysma prej tyre me arsim të lartë (në akademi diplomatike, tregtare, për drejtësi, mjekësi, ushtarake, klerik, funksionar në legatën franceze), pjesa tjetër tregtar, teknikë, sipërmarrës deri tek zanatçinj të thjeshtë kishin në mënyra të ndryshme lidhje me shtetin francez dhe shtetasit e funksionarët francezë në Shqipëri. Të ardhur përgjithësisht nga shtresa e lartë dhe e mesme e shoqërisë shqiptare të paraluftës, ishin persona që kishin lëvizur, kishin jetuar e punuar në disa vende të Europës. I akuzuari kryesor Agostin Bonati, punonjës i Legatës Franceze u dënua me vdekje me pushkatim, të terët me dënime nga 20 deri në 5 vjet. Rakip Strazimirit iu shua akuza për shkak se kishte vdekur gjatë hetuesisë. Arrestimet kanë nisur në maj të vitit 1947-maj 1949. Në procesin gjyqësor, gjashtë prej tyre (Agostin Bonati, Skender Konica, Skënder Shkupi, Patër Gjadri, Luçia Kola, Kosta Meksi) nuk i kanë pranuar deklaratat e bëra në hetuesi, duke thënë se janë marrë nën torturë. Avokatët e çështjes, Gaqo Stefa, Vangjel Xhomaka, ishin avokatë të Ministrisë së Brendshme Procesi me trupën gjykuese Mustafa Iliazi, (kap. I) – kryetar dhe Shaban Rexha (kap. I), Veli Lilaj (n/toger) – anëtarë, Mstan Cake (rreshter) – sekretar dhe Hilmi Telegrafi- prokuror nisi në 7 janar 1950 dhe vendimi nr. 301 i gjykatës ushtarake të Tiranës u mor në 8.7.1950. Vendimi i Gjykatës së Lartë Ushtarake nr.161, datë 29.7.950 vendosi ligjërimin e vendimit nr. 301, datë 8.7.1950 të Gjykatës Ushtarake Dosja përmban aktakuzë, procesverbale, fotografi, letra, vendimin e gjykatës ushtarake dhe vendimin e apelimit, ballafaqime Njëri prej të akuzuarve në këtë proces ishte Isuf (Jusuf) Vrioni i cili u akuzua për faje penale kundra shtetit, anëtar i organizatës tradhëtare social-demokrate dhe si agjent i spiunazhit francez në Tiranë. U arrestua më 13.7.1947 dhe doli në gjyq në 7 janar të vitit 1950. Me vendimin nr. 301, datë 8.7.1950 të Gjykatës Ushtarake të Tiranës dhe vendimin nr.161, datë 29.7.950 Gjykatës së Lartë Ushtarake u dënua me 15 vjet privim lirie pune të detyruar dhe heqjen e së drejtës elektorale për 5 vjet. Dosja e përpunimit nr.1452 është hapur në vitin 1964. Ajo përmban disa dokumente nga dënimi penal i Isuf Vrionit, raporte informimi nga të cilat merret iniciativa për ngritjen në përpunim 2A, plane masash, ekstrakte, detyra, deklarata, 3 foto dhe letra. Dosja mbyllet me vendimin e datës 27.7.1991 të Drejtorisë së Punëve të Brendshme.

MEDIA #1

Dosja nr. 1355-A

MEDIA FAQE #1



Dosja nr. 1355-A

INFORMACION

Dosja nr. 1355-A

FONDI	Nr. 1, hetimor-gjyqësor
STRUKTURA	Gjykata Ushtarake e Tiranës
DOSJA	1355-A
	1947-1956
	712
DATA E KRIJIMIT	-
LLOJI I DOKUMENTIT	Dosje hetimore-gjyqësore


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #2

Kapaku i dosjes së përpunimit

MEDIA FAQE #1



Kapaku i dosjes së përpunimit

INFORMACION

Kapaku i dosjes së përpunimit

FONDI	Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë
STRUKTURA	Drejtoria e Punëve të Brendshme, Dega Tiranë
	1964-1991
	171
DATA E KRIJIMIT	29.02.1964
GJUHA	Shqip
TIPOLOGJIA E DOSJES	Dosje përpunimi


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #3

Foto

MEDIA FAQE #1



Foto

INFORMACION

Foto

FONDI	Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë
DOSJA	1452
	1964-1991
	171


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #4

Aktakuzë

MEDIA FAQE #1



MINISTRIJA E P.MBRENDSHME
DREJTORIA SIGURIMIT SHTETIT
=Dega e VII-te=

Tirane,me_____19[illegible]

e/181

A K T - A K U Z E

Siç do te shifet dhe nga permbajtja e akteve hetimore qe u bashkangjitep; rezullton se :

I Pandehuri Isuf Vrioni: Biri te ndjerit Iljaz dhe i se gjalles [redacted] vjec 33, lindur ne Korfuz dhe banues ne Tirane,ish nepunes ne Sekretariatin e S.G.A.SH.-it, me arsim te nalte Universitet per Drejtesi e Ekonomi, i pa martuar, shtrese qytetare, ekonomikisht i pasem,i pa denuar ndonji here dhe i paraburgosur me date 13 Shtator 1947.-

Akuzohet se :

1-Mbas çlirimit te vendit,ka mbajtur qendrim armiqsor,duke u lidhur gjithmone me elementin reaksionar, aq ma teper me antaret e misioneve ushtarake te huaj,si me V[redacted]-C[redacted], R[redacted], T[redacted], S[redacted], T[redacted], D[redacted] dhe M/Togerin K[redacted] me te cilet takohesh perditë ne tenis-mallban,gjoja per qellime loje, dhe ne pushimet,tok me shokat e tjere A[redacted], B[redacted], S[redacted], M[redacted], S[redacted], F[redacted], V[redacted], Q[redacted], V[redacted], A[redacted], F[redacted], A[redacted], V[redacted] e tjer,bisedonin çeshtje politike,ekonomike dhe shoqnore,u jepnin informata ktyre mbi gjendjen e vendit dhe merrnin udhezime prej tyre se si do te veproninn ne punen e perditshme kunder interesave te vendit,dyke paraqitur nji ndrrim te situates nga nji shkrim i shpejt i Anglo-Amerikanve.-

Me rastin e shpronesimit te tij nga shume çiflige,qe ne to u instalua ma se 2o familje bujqish,u tremb dhe filloi te flase haptazi kunder Pushtetit, reformes agrare dhe reformave te ndryshme.-

2-Ftill mbas daljes se ligjes elektorale mbi gjidhjet e 2 Dhjetorit 1945,mori kontakt me F[redacted] dhe me anen e S[redacted] A[redacted] ç'faqi deshiren qe ky i fundit te formonte nji grup opozite per ne votimet,me sistem krejt perendimor dhe bile mbi gjedhjet ka formuluar nji trakt ne gjuhen frengjishte dhe ja u dergoje gazetarve Anglo-Amerikan,kopjen e te cilit e perktheu ne gjuhen Anglisht F[redacted] V[redacted].-

3-I pa ngopur ne punen e tij armiqsore,nepermjet te krye-agjentit A[redacted] B[redacted],vihet ne sherbim te spiunazhit francez dhe jep gdo informate me goje dhe shkrim me gdo karakter dhe per kete sherbim paguhet me nji rroge mujore prej [redacted] franga ngj. ne muaj dhe sa here qe i jepte ndonji informate te rendesishme, shperblehesh plus rroges qe merrte.-

Ka dhane informata mbi Sekretariatin e Gruas ku i pandehuri sherbente, ka dhane gjithashtu informata dhe mbi Sekretariatin e Rinise,dhe ma vone ngarkohet qe te informoje dhe per çeshtje politike,ekonomike,shoqnore dhe ushtarake.-

4-Ma vone per aftesi dhe besim ne pune,ngarkohet qe te rekrutoje dhe informatore te rij ne sherbim te spiunazhit francez, duke u bazuar ne elementin e pa kenaqur dhe armik te Pushtetit ne administraten shtetnore,ku bile ka rekrutuar dhe Z[redacted] M[redacted] qe punonte ne Kryeministri.-

Faji i tij provohet:

Me deponimet e krye-agjentit A[redacted] B[redacted] dhe ato te ndihmesit te tij S[redacted] K[redacted],dhe me deponimet e te pandehurit S[redacted] S[redacted] te bame ne proçes verbalet e tyre,me ballafaqimet e B[redacted], S[redacted], A[redacted] dhe Fe[redacted], me nji ekstrakt te D[redacted] D[redacted] qe u bashkangjitet,dhe me shtatë deklarata te leshuara prej tij,te cilat tash i mohon;si dhe me shtat deklarate te leshuara nga F[redacted] V[redacted],qe dhe keto u bashjangjiten.-


Dyshimet t'ona:

Me gjith se ne proçes nuk ka pranuar,neve dyshojme se gjate okupacionit te kete ba pjese ne organizatat trathtare te ballit dhe legalitetit

%e

Aktakuzë

MEDIA FAQE #2



-2-

dhe te kete mbajte lidhje te ngushta me eksponentet e tyre Gaqo Doga dhe Kadri Cakrani,gja qe kjo i provohet dhe nga S[redacted] K[redacted].-

Dyshojme gjithashtu qe te kete ba pjese ne nji grup t'organizates Social Demokrate ne ne krye F[redacted] V[redacted],ku dhe ky grup organizate kishte per qellim t'ushtroje pune armiqsore ne dam te Pushtetit Popullor dhe ne interese te te huajve.-

Rrezikshmenija shoqnore;

Nga vete permbajtja e proçes verbalit te tij,shifet kjarte se i pandehuri paraqet nji rrezikshmeni shoqnore te theksueme,dhe formojme bindje se asht i tille kur shohim dhe qendrimin e tij rezistent dhe armiqsor,duke mbrojtur me vendosmeri punen e tij armiqsore n'interese te armiqve te jashtem.-

Qendrimi ne hetuesi :

Perpara hetuesis,ka mbajte nji qendrim nga ma armiqsorët,duke qendru shume i vendosur ne rrugen e trathtise dhe duke mos pranuar asnji nga akuzat qe atribuoheshin,por ma e keqja asht se p'asnji menyre nuk pergjegjesh rreth pyetjeve qe i beheshin,duke pretenduar se keta jane pyetje pa vend dhe te shkepatura,me nji fjale kerkonte qe hetuesija te ndjeki nji forme proçeduriale t'atille qe deshironte ky,dhe keto e bante gjithmone ne nji,koke kur vehesh ne pozita te veshtira dhe kur nuk kish ndonji baze mbrojtjeje.-

Per te bere fjale mbi qendrimin e tij para hetuesis,don koke, por mjafton te permendesh se kur asht ballafaquar prej S[redacted] M[redacted] me nji ton ma brutal dhe armiqsor,e ofendon keq (S[redacted]),duke i thane prej ma se shume here, i poshter, kjo nenkuptohet se e bente me qellim qe t'a frigonte S[redacted] dhe te mos tregonte aktivitetin armiqsor. Mjafton te permendish gjithashtu dhe deklaratën e mesiperme prej tij qe u beshkangjitet,ne te cilen verteton se nuk i asht pergjigjur pyetjeve qe i beheshin,duke thane se kesaj pyetjeje ne menyre lakonike nuk mund t'i pergjigjem.-

Persa siper, tue qene se i pandehuri ka kryer faje penale kunder Popullit e Shtetit, te parashikuara dhe ndeshkuara prej neneve 2,3 e tj, te ligjes Nr.372; date 12./XII/.1946,ju referohen aktet per kompetence e referim Gjykates kompetente per gjykimin e tij.-

Ministri P.Mbrendshme
Gjeneral-Lejtnant
(Mehmet Shehu)

Aktakuzë

INFORMACION

Aktakuzë

FONDI	Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë
DOSJA	Nr. 1452
	1964-1991
DATA E KRIJIMIT	1949
	171
KRIJUAR NGA	Mehmet Shehu, Ministër i Punëve të Brendshme
LLOJI I DOKUMENTIT	Aktakuzë


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #5

Mbrojtja ne gjyq

MEDIA FAQE #1



MBROJTJE E TE PANDEHURVE: AGOSTIN BONATI,
GULIELM RASKU, GJON CEFA, ISUF VRIONI, KOSTA MEKSI, AGOP KAHANEXHIAN

Shoku Kryetar !
Shokë gjyqtarë !

Të përfaqesuarit prej meje në mbrojtje Agostin Bonati, Gulielm Rasku, Gjon Cefa, Isuf Vrioni, Kosta Meksi, Agop Kahanexhian akuzohen: për lidhje spiunazhi me përfaqësues të misionit francez dhe të legatës, se u kane dhene atyre informata me karakter shtetnor dhe për punen e tyre armiqesore jane shperblyer me të holla.


Me gjith se të pandehurit para trupit gjykues e mohuan aktivitetin e tyre armiqësor kundra pushtetit popullor, të deponuar, prej tyre në Këtë Hetuesi ne vitin 1949, pa as nje presion dhe kercenim, siç deponuar dhe vetë, prap së prap gjatë procesit të gjyqit në prove te fajsise se tyre qëndruan njaft fakte dhe prova që tregojne lidhjet e të pandehurve me elementin e misionit dhe te legatës franceze.

Nuk mund të mos përmend se procesi i këtij gjyqi zbuloi edhe nje herë, ashtu si shumë herë të tjera ne gjyqet e shkilluara më parë dhe tash së fundi, se imperialistet e kanë ndër më ay Shqipërinë e lirë dhe demokratike, dhe se ata përpiqen me çdo mjet dhe mënyre që t'organizojne në vendin tonë elementin armik të pushtetit dhe të popullit tone, ta hedhin ate ne sabotime, teror dhe ne perpjekje për përmbysjen e pushtetit te vendosur nga populli. Por ky proces zbuloi ne menyre te veçante se fill mbas çlirimit, porsa ardhi misioni francez i akredituar ne Shqiperi, ne vend qe te kryente misionin legal të tij, filloi nga puna armiqesore kundra ardhuet dhe pushtetit tonë duke vene ne sherbim shpinazhi elementin armik të pushtetit të popullit dhe duke i aktivizuar këta ne dëm të pushtetit. Keshtu me fakte dalin te kjarta qëllimet e armiqve tonë të jashtem kundrejt vendit dhe popullit tonë.

Por faktet e deshtimit të të gjitha tentativave armiqësore të imperialistave, tue filluar prej amerikano-englezëve dhe deri tek shërbëtorët e tyre titistë, monarko-fashistë, neofashistë dhe imperialistëve francezë te drejtuara kundra vendit tonë, kanë treguar se drejtësija e popullit ka triumfuar mbi tentativat e tyre të poshtëra kundra popullitë dhe Atdheut tonë, dhe se populli do të triumfojë sa herë që ata do të përpiqen te shkelin interesat e Atdheut tonë.

Por me gjithe akuzat qe rendojne mbi te pandehurit e permendur me lart dhe drejtësinë e dënimit të kërkuar nga shoku prokuror, unë në pozitën e mbrojtësit, që sigurisht nuk eshte te mbroje padrejtesisht fajtorët dhe vepren e tyre armiqesore, do te mundohem të zbuloj ato ana që janë në favorin e të pandehurve dhe që lehtesojne denimin e tyre, dhe t'i japë trupit gjykues ndihmën e mundeshme per dhënien e një denimi sa më të arsyeshëm dhe të drejtë.

MEDIA FAQE #2



- 3 -

I pandehuri Isuf Vrioni akuzohet si agjent i legates franceze, ne lidhje me Agostin Bonatin dhe Skender Konicen, te cilëve u ka dhene informata me karakter shtetnor dhe eshte shperblyer me te holla per këto pune armiqësore.

Fajesija e te pandehurit u provua deri diku ketu ne gjyq nga vete deponimet e tija si p.sh. komentet politike qe bente reth lajmeve te pushtetit duke i kritikuar ato (mos zbatimin e tyre siç thotë ay), se ka patur miqesi dhe takime me njerezit e misionit dhe te legates franceze, nga te cilet eshte shirurthe festat e tyre, i dergoheshin revista nga Robinsoni, lidhje këto qe s'ka si mos te te bejnë me lyshosh se ne këto mes qendrojn nje lidhje tjeter sa sa thjesht miqesore, mbasi ndërsa i pandehuri ka qene vetem nje penpunes i thjeshte. Por me gjithe këto nuk rezulton qe i pandehuri Isuf Vrioni te këto dhene informacion me rendesi te madhe shtetnore ose te këto kryer çfaredo vepre tjeter qe e ka damtuar rende pushtetin dhe popullin, dhe kjo e lefteson fajesin e tij.

Perveç kesaj, faji i kryer nga i pandehuri ka qene favorizuar nga shkaqe dhe kryer ne rethana te tilla siç jane: çpronesimi i tokave qe posedonte familja e tij, origjina e tij shoqerore prej bejlereshi, qe tere jeten kane sunduar mbi kurizin e popullit, rethi i tij shoqnor me pikpamje antidemokratike si dhe aktiviteti armiqesor i imperializmit kundrejt vendit tone, i cili u jepte shpresa per nje rivendosje te pushtetit te vjeter- te gjitha këto e shtynin te pandehurin te lidhej me elementin e legates franceze dhe te vihej ne sherbim te tyre.

Duke i konsideruar ca u permenden ma nalt si ane lehtesuese per ca ktimin e fajesis të të pandehurit, i lutem trupit gjykues qe ti mare ne konsideracion ne dhenjen e denimit.

Mbrojtja ne gjyq

MEDIA FAQE #2

INFORMACION

Mbrojtja ne gjyq

FONDI	Drejtoria e Punëve të Brendshme
DOSJA	1355-A
	1964-1991
	171
AVOKAT	Gaqo Stefo


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #6


Raport propozimi

MEDIA FAQE #1



Raport propozimi

MEDIA FAQE #2



INFORMACION

Raport propozimi

FONDI	Drejtoria e Punëve të Brenshme Tiranë
DOSJA	Nr. 1452
	1964-1991
	171
DATA E KRIJIMIT	29.02.1964
GJUHA	Shqip
LLOJI I DOKUMENTIT	Raport-propozim
	Shyqyri Karemani
APROVUAR NGA	Koço Pano, zëvendësdrejtor e Puneve të Brendshme


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #7

Raport

MEDIA FAQE #1



77-76 50

Marre nga P.Op.Riza Braho
Dhene nga B.P."Besniku"
Tirane me 23/X/1967.

RAPORT

Kur u perkthye dhe u botua raporti i shokut Enver ,mbajtur ne kongresin e V-te te Partise ne gjuhen ferngjisht, eshte bere nje gabim, ku ne vend te thuhej" klasa punetore nderkombetare", ishte perkthyer " borgjezia nderkombetare" dhe keshtu dolli ne qarkullim botimi i tij i pare, ndersa ky gabim u ndreq vetem kur u ribotua per te dyten here ne gjuhen ferngjisante. Perkthyes ka qene Isuf Vrioni , por faji nuk eshte vetem i ketij, por edhe i redaktorit i cili ka pe detyre ta kontrolloje jo vetem nga ana gjuhesore, por edhe permbajtje qe te mos shtremberohen fjalet e kuptimi i tyre.

Ne botimet politike qe dalin ne gjuhe te huaja ka pasur here pas here gabime edhe me pare. Arsyeja eshte se nuk ka kontroll rigoroz si ne cilesine e perkthimit ashtu dhe ne redaktim e karakterin letra re. Shpesh here gabimet qe konstatohen nuk denoncohen , me gjithe ato libri kontrollohet edhe pasi del nga shtypi, por redaktorat ruajne njeri tjetrin per tu shmangur nga pergjegjesia .

Ne muajin Korik korektorat e eshtit te shtypshkronjes sinja-lizuan ndermarjen e botimeve ato librin e shokut Enver " mbi riparimi nje frazo nuk lidhej dhe sikur kuptim, redaksia pas ketij sinjalizimi e regulloj gabimin, kjo tregon pakujdesin e tyre dhe po te mos qe sinjalizuar nga shtypshkronja libri do te delte me gabime. Edhe ne botimet letrare ka pasur gabime shume nga botimet.

Korektor teknik ne raportin e shokut Enver qe pati gabimin e lart permendur ka qene [redacted] . Ketu ka dy mundesi: ose nuk e ka konstatuar gabimin , ose e ka lene ne heshtje, me qellim.

DETYRA: "Besniku"

Te takohesh me Isuf Vrionin dhe bisedo rreth gabimeve ne perkthime, qellimi eshte te mesosh si reagon ky rreth ketyre gabimeve

Masa - Operative: Kjo e dhene te konsumohet duke biseduar me sekretarin e partise ne ndermarje e ti thuhet ketij qe keto duhet ti beje problem te kolektivit.-

" PUNETORI OPERATIV
/ Riza Braho /

Ne-ka
Nese u. dorëzua këtëti
nga ana materiale? Te
njëjtojmë k. Partë e. 1½
(Haxhi Meda)
27-X-67

Isuf Ilias Vrioni, i lindur në Berat me 1916
[redacted] NË

Raport

INFORMACION

Raport

FONDI	Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë
DOSJA	Nr. 1452
	1964-1991
	171
DATA E KRIJIMIT	23.10.1967
PUNETORI OPERATIV	Riza Braho

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.